

173/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KAMËZ**

Nr. 3288/1 prot.

Kamëz, më 22.10 2015

**Lënda:** Kthim përgjigje.

**Drejtuar:** Qendrës “Res Publica”  
*Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.24, H.3, Ap.44, Kati 9,*

**Tiranë.**

Në përgjigje të shkresës suaj nr.173/15 prot., datë 09.10.2015, protokolluar me tonën nr. 3288 prot., datë 12.10.2015, ju informojmë se, Bashkia Kamëz, në mbështetje të Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për qeverisjen vendore”, i ndryshuar, ka ngritur pranë saj si strukturë funksionale Ndërmarrjen e Pastrim-Gjelbërimit e Treg, e cila ushtron funksionet për grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave.

Bashkëngjitur do të gjeni:

1. Kopje të planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në territorin e Bashkisë Kamëz.
2. Kopje të vlerësimit strategjik mjedisor.
3. Listën e vendeve të mbledhjes/depozitimit të mbetjeve.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj,



## Pershkrimi i pergjithshem:

Bashkia Kamez ben pjese ne Rajonin e Tiranës se Madhe dhe perfshin qytetin e Kamzes, pese fshatra (Laknasi, Valiasi, Valiasi i Ri, Zall-Mneri, Bulceshti) dhe dy vendbanime informale (Bathore dhe Frutikulture). Bashkia e Kamzes eshte e vendosur 7 km ne veri te qendres se kryeqytetit, dhe ndodhet ngjitur me korridorin ekonomik Tirane-Durres, Aeroportin Nderkombetar "Nene Tereza" dhe rajonin historik te Krujes.

Bashkia Kamez u perball gjate viteve '90 me nje migrim masiv nga zonat rurale duke ndryshuar ne vitin 1996 statusin administrative rural ne nje Bashki duke perfshire brenda kufijve te vet 2100 ha toke. Prej kesaj vetem 310 ha toke jane klasifikuar si toke urbane. Nga kendveshtrimi juridik pjesa me e madhe e tokes eshte ne pronesi te ish-fermereve. Bashkia e Kamzes i sherben nje popullsi qe arrin deri ne 47,000 banore, 35% e te cileve jane nen moshen 15 vjec.

Kryesisht Kamza ka nevojë për të gjetur mënyra dhe mjete për të shfrytëzuar mundësitë e veta social-ekonomike dhe hapësinore në kontekstin kombëtar duke identifikuar dhe maksimizuar përparësitë potenciale lokale dhe krahasuese në zonën metropolitane të Tiranës. Bashkia duhet të përpiqet për të krijuar një mjedis urban të integruar dhe kompleks brenda të cilit popullsia ekzistuese dhe te ardhurit te jene në gjendje për të kërkuar dhe realizuar mundësitë për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre

## Sistemi I mbledhjes se mbeturinave

### • Kontrolli nëse autoritetet kanë krijuar një shërbim të grumbullimit të mbeturinave

Ekziston një system i mbledhjes se mbeturinave. Ky shërbim administrohet nga Bashkia dhe nuk është privat. Sistemi I Mbledhjes se mbeturinave ka në dispozicion 7 makineri-në të gjithë zonën e Kamzës, këto makineri janë:

- New Traktor 1
- Automjete të reja teknologjike "Isuzu" 1
- Automjeteve te medha teknologjike 1
- Kamion IVECO 1
- Tricikel 1
- Autobot Uji 1
- Automjet Vetë-shkarkues 1

Në zonën e Kamzës janë 208 vende të mbledhjes se mbeturinave, 80 prej tyre me enë dhe 128 vende të ekspozuara.

- **Identifikimi i zonave te mundshme të prekura nga shërbimi i mbledhjes dhe për të kontrolluar nëse zonat e grumbullimit janë të kontrolluara ose jo**

E gjithë zona e Kamzës përfshihet nga sistemi I mbledhjes se mbeturinave por në disa zona ky shërbim është i vështirë për shkak se disa vende të mbledhjes se mbeturinave nuk kanë kontenitore dhe mbeturinat hidhen në fushë. Disa zona (si Bathore) kanë pak vende për mbledhjen e mbeturinave dhe ato hidhen në fushë.

Ka tre skema shërbimi:

1. Skema e mbledhjes me kontenitore/enë (kazane)
2. Skema e mbledhjes në vende të ekspozuara
3. Skema e mbledhjes në çdo ndërtesë

### **1. Skema e mbledhjes me kontenitore (kazane)**

Kjo skemë aplikohet në ato zona që janë të pajisura me infrastrukturë rrugore dhe makinerite teknologjike mund të levizin lirshëm. Këto zona përfshijnë rrugët:

- a. Nga FAFA – Kompleksi Shpresa AI
- b. Kruqesimi I Kamzës – Qender Laknas
- c. Qender Kamez – Karburanti Albavia, qyteti Kamez
- d. Kthesa e Bathores - Bathore

Këto segmente pastrohen përditë me automjete teknologjike. Aktualisht janë 80 kontenitore (kazane) metalike.

### **2. Skema e mbledhjes në vende të ekspozuara**

Kjo skemë aplikohet në zonat e mëposhtme:

- a. Valias I ri,
- b. Koder Lite,
- c. Bulcesh,
- d. Kamza e vjeter,

- e. Frutikulture,
- f. Teqja Valias.

Kjo skeme mbledhje aplikohet tre here ne jave dhe realizohet nga nje mjet I madh teknologjik IVEKO per shkak te gjendjes se keqe te infrastruktures rrugore

### 3. Skema e mbledhjes në çdo ndërtesë

Kjo skeme aplikohet ne:

- a. Zonen e vjeter te qytetit Kamez
- b. Lagjen 6 Bathore
- c. Ne nje lagje te Laknasit

Kjo skeme aplikohet nje here ne jave

**Tabela 1: Sasiste vjetore te mbetjeve urbane**

Mjete te renda teknologjike	Perdite / 2 rruge Mujore / 60 Vjetore / 730	7 ton 7 ton 7 ton	14 ton 420 ton 5110 ton	5544 ton
Automjete teknologjike Isuzu	Perdite / 4 rruge Mujore / 120 Vjetore / 1460	3.5 ton 3.5 ton 3.5 ton	14 ton 420 ton 5110 ton	5544 ton
Mjete Vete-shkarkuese Iveco	Perdite / 2 rruge Mujore / 60 Vjetore / 730	8 ton 8 ton 8 ton	16 ton 480 ton 5840 ton	6336 ton
Mjete Vete-shkarkuese Man	Perdite / 2 rruge Mujore / 60 Vjetore / 730	4 ton 4 ton 4 ton	8 ton 240 ton 2920 ton	3168 ton

**Tabela 2: Siperfaqet e ndarjes se zones se Kamzes**

- Qyteti Kamez	= 105 ha
- Fshati Kamez	= 432 ha
- Bathore	= 504ha
- Bulcesh	= 9 ha
- Zall-Mner	=
56 ha	
- Valias	=576 ha
- Valias I Ri	=108 ha
- Frutikulture	=168 ha
- Laknas	=415 ha
<b>TOTAL</b>	<b>=2,373 ha</b>

Per te mbuluar te gjithë zonen e Kamzes me Kosha Mbeturinash (Kazane) mbledhese duhen rreth 200 njesi te reja, nje pjese e te cilave duhen per te zevendesuar njesite e vjetra

**Table 3: Vendet qe duhet te plotesohen me konteniere (kazane)**

No	Rruge te reja	Siperfaqe ne m2	No. Kontenier
1	Lagje 6 Bathore	12.970	12
2	Shkolla e Re Kamez	1.750	5
3	Lagje 4 Kamez	1.980	5
4	Lagje Lura	6.300	9
5	Lagja Korcare	7.500	10
6	Bathore	3.900	7
7	Shkolla Bathore+Aks inst. Bulcesh	2.200	4
8	Shkolla. Bathore 2 dhe Ura	450	4
9	Rruga Frutikulture + Lagja Gramshioleve	1.920	5
10	Rruga Co-Plan	1.980	5
11	Para shkolles, kopshtit Zall-Mner	1.620	5
12	Rruga Frutikultres +Zall-Mner	2.400	6
	<b>Total</b>		<b>77</b>

**Tabela 4: Sasia e konteniereve dhe pikave te mbledhjes**

No	Pika Grumbullimi	Numer Kontenieresh
1	Fusha Kacareve	5
2	Shkolla 9-jecare, Kamez	2

3	Kryqezimi I Frutikultures (stacioni urban)	3
4	Fafa OIL	3
5	Qender Valias	10
6	Qender Laknas	6
7	Rruga Cerkeze	6
8	Lagje 5, Kamez (Tropojaneve)	8
9	Unaza Kamez ring	10
10	Pika prane 5009-es	6
11	Bulcesh	4
12	Kryqezimi Bathore	4
13	Xhamia e Vogel Valias	3
14	Qender Valias I Ri	4
15	Rruga e Laknasit	6
16	Rruga e Zall-Mner	6
17	Unaza Frutikulture	14
18	Koder Lite, deri ne UBT (Universiteti Bujqesor i Tiranës)	10
	TOTAL	110

- **Identifikimi i vendndodhjes se zonave te grumbullimit te plehrave nese ato ndodhen ne periferi apo jashte kufijve te autoritetit perkates.**

Bregu I lumit Terkuza eshte e vetmja pike grumbullimi plehrash e percaktuar nga autoritetet por ne periferi ka mungese kontenieresh dhe hedhja e mbeturinave kryhet ne vende te ndryshme.

- **Identifikimi i vendndodhjes dhe kufijte e zones se hedhjes se mbeturinave**

Kufijte e zonave te hedhjes se mbeturinave

- Ne Veri me Lumin Terkuza
- Ne Lindje me Lumin Terkuza
- Ne Perendim me rrugen nacionale Tirane-Shkoder
- Ne Jug me toke bujqesore

Kjo zone ndodhet 2,2 km nga qendra e Kamzes ne Veri-Perendim te qytetit Kamez. Zona e grumbullimit ndodhet afer rruges nacionale Tirane-Shkoder, ne breg te lumit Terkuza. Kjo zone nuk eshte nje zone grumbullimi e mirefillte por nje zone hedhje mbeturinash.

- **Analiza e kufizimeve te zhvillimeve te reja**

Kamza nuk ka nje studim urban te miratuar dhe zona e lumit Terkuza nuk eshte zone e percaktuar vendbanimi. Zhvillimet e menjehershme gjate viteve te fundit kanë bere qe mbetjet urbane te shtohen, nderkohe qe ka patur nje mungese te theksuar te kontejnerëve

dhe automjeteve teknologjike. Banorët kanë filluar të përdorin kanalet e kullimit dhe bregun e lumit për hedhjen e mbeturinave.

- **Identifikimi i zonave që kërkojnë trajtim korrigjues**

Në këtë zonë nuk ka vendshkarkime të tjera si vendshkarkimi në breg të lumit Terkuza, (sipas informacioneve të Bashkisë Kamzës). Vendshkarkimi në breg të lumit Terkuza kërkon trajtime përmirësuese, për shkak të shkarkimit të ujërave të ndotura drejt lumit Terkuza, që duke patur një taban ranor ndikon nepermjet filtrimit në ndotjen edhe të ujërave nëntokesore.

- **Percaktimi i pranisë së substancave të mbetjeve të rrezikshme në këto zona**

Në vendshkarkimin e mbetjeve urbane gjenden të gjitha llojet e mbeturinave. Në zonën e Kamzës, kanë një mungesë të ndarjes së mbetjeve urbane, spitalore, industriale, ndërtimore dhe mbeturinat e përgjithshme mbledhen së bashku. Vendshkarkimi i Terkuzes nuk është i mbyllur dhe kushdo kurdo mund të hedhë gjithçka.

- **Projekt idea e vendit të hedhjes së mbeturinave (Pastrimi i vendshkarkimit ekzistues “ Bregu i lumit Terkuze”**

1. Pastrimi i mbetjeve Urbane

- Në të dy akset rrugore
  - Transporti i mbetjeve / mbeturinave (1000m<sup>3</sup>)
  - Heqja e mbetjeve/mbeturinave nga bregu i lumit (1400m<sup>3</sup>)
  - Grumbullimi dhe kompresimi i mbeturinave (2200m<sup>3</sup>)
- Në rrugën dytesore (në degen e majte)
  - Transporti i mbetjeve / mbeturinave (1600m<sup>3</sup>)
  - Shkarkimi /kompresimi i mbeturinave (1200m<sup>3</sup>)
  - Izolim mbulues me argjilë të pastër (20cm) (540m<sup>3</sup>)

Grumbullim/Kompresim mbeturinash

2. Pastrimi i rrugëve të brendshme

- Rruge ekzistuese me gjatësi 520 meter linear
  - Nivelin i sipërfaqes (3120m<sup>2</sup>)
  - Shtrim me zhavorr dhe nivelim (468m<sup>3</sup>)

3. Rrethimi /Porta hyrëse e pikës së grumbullimit

- Grumbullimi (0.5\*0.5\*0.7) 85cp

- Tre rreshta me tela me gjemba (280ml)
  - Porta Metalike (4ml, 4m2)
4. Grumbullimi pasiv /Krijimi I parcelave te reja /Rruge
- Grumbullim /Transport /Nivelim (800m3)
  - Mbushja e gropave pas nivelimit (1400m3)
  - Izolimi me argjile te paster 20cm (1600m3)
  - Hapja / Kompresimi me makineri (8000m3)
  - Hapja e rrugeve per parcelat e reja
  - Mbulim me zhavorr/ cakull 15cm (300m3)
5. Kullimi I ujrave
- Germin/pastrim kanalesh (1.5\*2\*100)m (300m3)
  - Mbulim me **Chippings** (200m3)
  - Mbulim me zhavorr/cakull (100m3)
  - Mbulim me argjile /Kompresim (60m3)
6. Pergatitja e gropave per grumbullimin e plehrave
- Pergatitja e siperfaqes se gropave pas hedhjes se zhavorrit/ cakullit (8000m2)
  - Mbulim me argjil te paster 20cm /Kompresim (8000m2)

**Tabela 5: Buxheti I Bashkise per vendgrumbullimin e plehrave te Terkuzes–Projekt-Ide**

Nr	Permbajtja e vendgrumbullimit te plehrave	Kosto ( lek)
1.	Largimi i plehrave nga rruget kryesore	1.298.000
2.	Pastrimi I rrugeve te brendshme	405.000
3.	Rrethimi dhe krijimi I portave hyrese	426.000
4.	Pastrimi pasiv/ Krijimi I parcelave te reja	1.176.000
5.	Pergatitja e rrugeve per parcelat e reja	315.000
6.	Grumbullimi I plehrave	2.560.000
7.	Kolektori I sistemit te kullimit	529.000
<b>Total</b>		<b>6.710.000</b>



### Legjenda e hartes se vendgrumbullimit te plehrave

- Lum
- Parcela te reja
- Pikat e marries se zhavorrit
- Rruge hyrese
- Vendet e mbeturinave
- Rruge ne projekt

